




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO


- Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
- Nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës
- Datë: 21 tetor 2022
- Lënda: **RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 korrik – 30 shtator 2022**



Fillimi i tremujorit të tretë të vitit 2022, e ka gjetur Gjykata Supreme me 370 lëndë të kryera, derisa gjatë kësaj periudhe kanë mbetur të pakryera edhe 371 lëndë të tjera.

Gjatë këtij tre-mujori, në punë kanë qenë 741 lëndë, derisa janë pranuar 328 lëndë të reja.

Të kalkuluar në përqindje, kemi grafikonin në vijim:



1. Raport i tremujorit të III-të, shprehur në përqindje, 370 lëndë të kryera, 371 të pakryera

Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe, që përfshijnë:


117 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë,

166 Revizione,

19 Revizione ekonomike.


31 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

25 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ.



2. Lëndët e kryera, sipas kërkesave të pranuar

E kalkuluar në përqindje, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, del të jetë 112.80 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.



3. Shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve 112.80 për qind


## Publikimi i vendimeve

Gjatë tremujorit të tretë, Gjykata Supreme ka vazhduar me publikimin e aktgjykimeve dhe aktvendimeve. Kështu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar gjithsej 600 vendime.

Gjatë muajit korrik janë publikuar 189 vendime, gjatë muajit gusht janë publikuar 300 vendime, gjatë muajit shtator janë publikuar 111 vendime.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë publikuar 4 vendime disiplinore.

Nga 600 vendimet e publikuara, 380 prej tyre janë vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme<sup>1</sup>. Po ashtu, janë publikuar katër (4) vendime të kryetarit të Gjykatës, lidhur me ankesat disiplinore<sup>2</sup>.



4. Gjatë tremujorit të III-të, janë publikuar 600 vendime

<sup>1</sup> <https://supreme.qjqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

<sup>2</sup> <https://supreme.qjqesori-rks.org/vendimet-disiplinore/>

## **Avancimet në Gjykatë Supreme**

Gjatë muajit shtator, KGjK, në kuadër të procesit të avancimit për gjyqtarë, ka avancuar dy (2) gjyqtarë në Gjykatën Supreme, gjyqtarin Afrim Shala, në degën penale dhe gjyqtaren Milena Đerić, në degën civile<sup>3</sup>.

Mandati i gjyqtarëve në fjalë ka filluar nga data 01 tetor 2022.

## **Komisioni konsultativ për Politikë Ndëshkimore**

Komisioni konsultativ për Politikë Ndëshkimore, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka vazhduar takimet dhe vizitat studimore. Kështu, me datë 7 shtator, kryetari i Gjykatës Supreme, njëherësh kryesues i Komisionit Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore, Enver Peci, ka mbajtur takimin e radhës lidhur me reformën në politikën ndëshkimore, me kryetarin dhe gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, e ku të pranishëm ishin edhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, kryetarët e gjykatave themelore, kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, si dhe anëtarë të Komisionit për Politikë Ndëshkimore dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Prishtinë<sup>4</sup>.

Po ashtu, Komisioni konsultativ për Politikë Ndëshkimore ka mbajtur takim pune më 14 dhe 15 shtator, lidhur me revidimin e Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore. Gjatë takimeve punuese, komisioni ka dhënë kontributin e tij, në komentet specifike të prezantuara nga ekspertja ligjore e Ambasadës Amerikane, me qëllim të finalizimit të këtij udhëzuesi.

Gjatë muajit shtator, Komisioni ka qëndruar për vizitë studimore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku është njohur nga afër me praktikat amerikane në fushën e drejtësisë, me theks në zbatimin e udhëzuesve për politikë ndëshkimore<sup>5</sup>.

---

<sup>3</sup> <https://ëëë.gjyqesori-rks.org/2022/09/22/kgjk-ka-perzgjedhur-dy-2-gjyqtar-per-avancim-ne-gjykatën-supreme-2/>

<sup>4</sup> <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/09/07/reforma-e-politikes-ndeshkimore-fokusi-te-gjykata-e-apelit/>

<sup>5</sup> <https://supreme.gjyqesori-rks.org/2022/09/21/komisioni-per-politike-ndeshkimore-vizite-studimore-ne-shba-2/>

### **Shpenzimet e Gjykatës Supreme dhe të Dhomës së Posaçme**

Sa i përket shpenzimeve, Gjykata Supreme, përfshirë Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në periudhën janar-shtator ka shpenzuar 21.576 euro. Mbi 50 për qind të kësaj shume, janë shpenzime të Dhomës së Posaçme, përfshirë shpenzime postare, telefonike dhe shpenzime tjera telekomunikimi, të cilat janë të domosdoshme për specifikat e punës në DhPGjS.

<b>RAPORT PËR PUNËN NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS</b>					
<b>PËR PERIUDHËN 1.07.2022 DERI MË 30.09.2022</b>					
	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "PA"	1	1	2	1	1
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	38	108	146	117	29
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	6	26	32	31	1
Revizion "Rev" "Rev II"	295	113	408	166	242
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	9	9	18	4	14
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	1	1	2	1	1
Civile të ndryshme "CN"	2	1	3	1	2
Revizione ekonomike "E.Rev"	53	6	59	19	40
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	1	1	1	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	0	0	0	0	0
A.Rev.	0	2	2	2	0
ARJ	8	51	59	25	34
Ankesa administrative "AA"	0	8	8	2	6
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "KML"	0	0	0	0	0
Ankesa për paraburgime "PN.II"	0	1	1	0	1
Penale Ndihme Juridike Nderkombetare "PNJD"	0	0	0	0	0
Administrative të ndryshme "AN"	0	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>413</b>	<b>328</b>	<b>741</b>	<b>370</b>	<b>371</b>